



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Planimar / Datojezat Punjeim/Prodato Received/Deliverty	22. 03. 2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Post Dr Post Post No	Shtypje e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMHM	1521/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.175/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1503/2020 të datës 18.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.186/2020 të datës 13.07.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ lidhur me ankesën A.nr.186/2020 të datës 13.07.2020 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 13.07.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndaj ankesës me numër protokollit 221/20 të datës 01.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 1610/2020 të datës 24.08.2020, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës numër A.nr.186/2020 të datës 13.07.2020, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetent në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesi me datë 10.09.2020 ka ushtruar ankesë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Ndërsa kjo e fundit, më datë 18.02.2022 ka nxjerrë

Aktgjykim A.nr.1503/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 24.08.2020, dhe ka detyruar të njëjtin që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e datës 13.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 13.07.2020 me numër protokoll 1350/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.03/82 të datës 04.07.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Themelimin e Strukturave Institucionale për Koordinimin e Zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave; Vendimin e datës 14.02.2014 me Nr.08/170 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e vendimi Nr.03/82 të datës 04.07.2012; Listën e Pagës për Ankesën e datës 01.06.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë e Punëve të Brendshme; Kontratën e marrëdhënies së punës me nr.03/2019 të datës 01.08.2019; Provat shtesë në referim të Aktgjykimit A.nr.1503/2020; Parashtresën e paditësit për ndryshimin dhe plotësimin e padisë të parashtruar në Gjykatë me datë 10.09.2020; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit e datës 08.03.2022 bashkë me shkresat e lëndës; Kartelën e nëpunësit të datës 07.03.2022; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 02.09.2019; Vendimin A.nr.399/2021 i datës 21.06.2021 me numër protokoll 3246/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.20/2019 të datës 04.03.2021 me numër protokoll 974/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.399/2021 i datës 21.06.2021 me numër protokoll 3246/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 10.03.2011 e parashtruar nga [redacted] për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën e datës 10.03.2011 e parashtruar nga [redacted] për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; E-mailin zyrtar të datës 12.08.2020; E-mail zyrtar të datës 29.07.2020; Opinioni në lidhje me Vendimin e Qeverisë për Sekretariatit për Liberalizimin e Vizave; E-mailin zyrtar i datës 19.01.2021 dhe Raporti i Auditimit me kërkesë të datës 09.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundoj procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.186/2020 të datës 13.07.2020 , *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se bazuar në Marrëveshjen për Bursë 2016/2017, në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12.07.2016, ankuesi është punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme sipas Kontratës së punës me numër protokoll 542 të datës 01.08.2019, në vendin e punës *Zyrtar i Lartë për Koordinim të Politikave* në Departamentin për Integritet Evropian, për periudhën tre vjeçare gjegjësisht nga data 01.08.2019 deri me 01.08.2022. I njëjti me datë 01.06.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 220/20 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të moszbatimit të Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Themelimin e Strukturave Institucionale për Koordinimin e Zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave.

Ankuesi pas heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme (tutje MPB) me datë 13.07.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 1350 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 të Qeverisë së Republikës së



Kosovës, ankuesit i njihet e drejta e pagës shtesë në vlerë 250 Euro, e të cilën shtesë ankuesi nuk e ka marrë asnjëherë. Andaj, kërkon që Këshilli të detyroj organin e punësimit që ankuesit ti bëjë kompensimin e pagës shtesë prej 250 Euro, në mënyrë retroaktive nga data 01.08.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se me datë 07.05.2021, ankuesi se bashku me dy koleget e tij dhe kishin parashtruar ankesë me qëllim dhe objekt të njëjtë sikurse në ankesën në shqyrtim, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër A.nr.399/2021 të datës 21.06.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueseve të datës 07.05.2021.

Andaj, Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë vlerëson se objekti i ankesës A.nr.186/2020 i datës 13.07.2020 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit të datës 07.05.2021, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me datë 21.06.2021 përmes Vendimit A.nr.399/2021, rrjedhimisht objekti i të dy ankesave bazohet në të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, e që në rastin konkret është njohja e pagës shtesë në vlerë prej 250 Euro sipas Vendimit Nr.03/82 të datës 04.07.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data e themelimit të marrëdhënies së punës konkretisht nga data 01.08.2019. Kështu që, nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë..* Kolegji konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.186/2020 të datës 30.07.2020 të parashtruar nga ankuesi

Ashtu siç u tha me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.175/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

